

20230390713

**LIGJ I GARANCISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR
DETYRIMET SIPAS MARRËVESHJES SË HUAS LIDHUR ME FINANCIMIN E
PROGRAMIT TË ENERGIJË SË RIPËRTËRITSHME EMV - KOMPONENTI I:
RIVITALIZIMI I HIDROCENTRALEVE, QË DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS
KREDITORE PËR RINDËRTIM - KFV DHE SHOQËRISË AKSIONARE TË
PRODHIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE ELEKTRANAT E MAQEDONISË SË
VERIUT, NË PRONËSI SHTETËRORE, SHKUP**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut garanton shlyerjen e detyrimeve dhe plotësimin e dispozitave të Marrëveshjes së huas lidhur me financimin e Programit të energjisë së ripërtëritshme EMV - Komponenti I: Rivitalizimi i hidrocentraleve, që do të lidhet ndërmjet Bankës Kreditore për Rindërtim - KFV dhe Shoqërisë Aksionare të Energjisë Elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, në vlerë prej 25.000.000 euro, nëse Shoqëria Aksionare e Prodhimit të Energjisë Elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, nuk i përmbush dhe nuk i servison detyrimet nga Marrëveshja e huas.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas janë përcaktuar me Marrëveshjen e huas sipas nenit 1 të këtij ligji, që do të lidhet ndërmjet Bankës Kreditore për Zhvillim – KFV dhe Shoqërisë Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, të Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup për financimin e Programit të energjisë së ripërtëritshme EMV – Komponenti I: Rivitalizimi i hidrocentraleve.

Neni 3

Të gjitha detyrimet që rezultojnë nga Marrëveshja e huas sipas nenit 1 të këtij ligji, si dhe servisimi i huas, do t'i shlyejë Shoqëria Aksionare Elektranat e Maqedonisë së Veriut, Shkup, nga të hyrat që realizon në kuadër tëafateve dhe kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e huas sipas nenit 1 të këtij ligji.

Neni 4

Afati i shlyerjes së huas sipas nenit 1 të këtij ligji është 15 vjet, duke përfshirë periudhën grejs prej pesë vjetësh.

Norma e interesit do të përcaktohet veçmas për çdo transhe të huas pas tërheqjes së saj.

Gjatë tërheqjes së secilës transhe vijuese, llogaritet normë mesatare e ponderuar e interesit e cila do të zbatohet për vlerën e tërhequr të huas.

Huaja do të shlyhet me këste gjysmëvjetore që arrijnë për pagesë në datën 30 qershor dhe 30 dhjetor.

Neni 5

Shoqëria Aksionare e Prodhimit të Energjisë Elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, do t'i paguajë Bankës Kreditore për Rindërtim - KFV provizion të njëhershëm në vlerë prej 0.75% të vlerës së huas, para tërheqjes së transhesë së parë të huas, ndërsa nëse në afat prej tre muajve nga lidhja e Marrëveshjes së huas sipas nenit 1 të këtij ligji,

Shoqëria Aksionare e Prodhimit të Energjisë Elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, nuk e kryen tërheqjen e transhesë së parë të huas, do t'i paguajë Bankës Kreditore për Rindërtim - KFV provizion të njëhershëm në vlerë prej 0.75% të vlerës së huas.

Shoqëria Aksionare e Prodhimit të Energjisë Elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, do t'i paguajë Bankës Kreditore për Rindërtim - KFV provizion në vlerë prej 0.25% nga mjetet e patërhequra të huas në nivel vjetor, që paguhet në këste gjysmëvjetore, që arrijnë për pagesë në datë 30 qershor dhe 30 dhjetor.

Provizionin nga mjetet e patërhequra nga paragrafi 2 i këtij neni, Shoqëria Aksionare e Prodhimit të Energjisë Elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, do ta fillojë ta paguajë në afat prej gjashtë muajve nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes së huas sipas neni 1 të ligjit në fjalë.

Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella që rezultojnë nga Marrëveshja e huas sipas neni 1 të këtij ligji dhe Marrëveshja e garancisë, Ministria e Financave dhe Shoqëria Aksionare e Prodhimit të Energjisë Elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, do të lidhë marrëveshje të veçantë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.